

TREGIMI I PEJGAMBERIT
SULEJMAN



Özkan Öze
Ilustroi: Sevgi İçigen

TREGIMI I PEJGAMBERIT
SULEJMAN



Në pamjet që ilustrojnë libërthat e kësaj serie botimesh për fëmijë nuk do të shihni asnjë nga fytyrat e pejgamberëve. Kjo sepse muslimanët nuk bëjnë portrete të pejgamberëve, për shkak të respektit që ndiejnë ndaj tyre.



BOTIMET E KRYESISË SË ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË: 1706/8
Libra për fëmijë: 349/8

Drejtuesi i botimeve:

Dr. Fatih Kurt

Koordinatori i botimeve:

Lokman Arslan

Analizimi i veprës:

Hale Şahin

Elif Erdem

Editor

Zeynep Ulviye Özkan

Përktheu

Florida Kulla

Redaktor gjuhësor

Fatjon Cuka

Ndjekja e botimit

Uğur Altuntop

Botimi

Bapak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

Tel.: +90 312 397 16 17

Botimi i tretë, Ankara 2019

2019-06-Y-0003-1706

ISBN 978-605-7730-91-6

Numri i certifikatës: 12930

Vendimi i komisionit të hetimit të veprave : 12.11.2019/111

© Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë

Kontakt

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı


Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr





Shumë e shumë kohë më parë, mbret i Palestinës ishte Pejgamberi Davud.

Ai ishte edhe një mbret i mirë,

por ishte edhe i dërguari i Allahut

Natën e ditë bënte vetëm vepra të mira.

Allahu i kishte dhënë atij Sulejmanin,

i cili ishte djali i Pejgamberit Davud.

Edhe Sulejmani ishte ashtu siç duhej të ishte një djalë pejgamberi:

shumë i mençur, i pjekur dhe me një zemër të madhe, që donte Allahun.

Një ditë prej ditësh, dy burra nga fshati erdhën te Pejgamberi Davud.

Delet e njërit prej tyre kishin hyrë në arën e tjetrit


I zoti i arës i tha: "Më kanë ngrënë të mbjellat!"

Tjetri tha: "Unë nuk kam faj! Delet kanë hyrë pa e ditur unë!"

Pejgamberi Davud i dëgjoi fshatarët me kujdes

dhe tha: "Ti duhet t'ia japësh delet atij, sepse i kanë ngrënë të mbjellat!"





Sulejmani e kundërshtoi: "Por, babai im i dashur! Kjo do të ishte padrejtësi! sepse delet e këtij burri kanë hyrë në arë pa e ditur ai. Më mirë do të ishte t'ia jepnim bujkut delet për pak kohë.

T'i mjelë ato dhe t'ua japë qumështin e tyre fëmijëve! Kur të rriten të mbjellat sërish, t'ia kthejë delet pas." Ky mendim i pëlqeu shumë Pejgamberit Davud, Sepse Sulejmani kishte marrë një vendim të drejtë. Kur Pejgamberi Davud u largua nga kjo botë, Sulejmani u bë mbret



Allahu i dha edhe atij detyrën e pejgamberit
dhe ia shtoi shumë e më shumë pasurinë.
Pa dyshim Pejgamberi Sulejman,
ishte një rob që e falënderonte shumë Allahun.
Allahu i mësoi Pejgamberit Sulejman gjuhën e
zogjve.
Çdo gjë që thoshin zogjtë,
ai e kuptonte.





Dhe i dha fuqinë të komandonte erën.
Fluturonte bashkë me erën, shkonte shumë
larg, si të ishte re.
Dhe Allahu bëri xhindët si shërbëtorë të tij.
U jepte punë atyre në çdo fushë.
Të gjithë e donin shumë Pejgamberin Sulejman.
Ai ishte një mbret shumë i drejtë, shumë bujar dhe
zemërmirë.
Përveç kësaj, ishte edhe një pejgamber i madh.
Pejgamberi Sulejman kishte një ushtri që përbëhej
nga njerëzit, xhindët dhe nga kafshë të llojeve të
ndryshme.

Një ditë u nis drejt Mekës bashkë me ushtrinë e tij.
Vizitoi Qabenë dhe bëri shumë adhurime aty.
Në kthim u strehua në shkretëtirë.
Pejgamberi Sulejman kishte një zog me emrin
Hud-hud,
i cili nuk dihej përse kishte humbur ato çaste.
Pejgamberi Sulejman tha me vete:
"Pse nuk po e shoh Hud-hudin? Mos ka
humbur vallë?"
Pa kaluar shumë kohë Hud-hudi
erdhi.





Pejgamberi Sulejman tha: "Nga ishe ti?"

Hud-hudi tha: "Unë mësova diçka që ti nuk e di."

Hud-hudi kishte vajtur në vendin e quajtur Sebe.



Shteti Sebe kishte një mbretëreshë të quajtur Belkis.

Mbretëresha Belkis dhe populli i saj adhuronin diellin, sepse ata nuk besonin në Allah.

Ndërkohë që dielli ishte një ndër yjet e Allahut

Dhe sa e sa yje kishte në qiell.

Si mund të adhuronin diellin?

Hud-hudi tha: "Shejtani i kishte mashtruar keqas ata!

Adhuronin diellin.

Ndërkohë që zoti i tokës dhe i qiejve është Allahu, i cili është një dhe i pangjashëm.

Pejgamberi Sulejman duhej të paralajmëronte popullin Sebe dhe mbretëreshën Belkis, duhej të bënte të mundur që ata të hiqnin dorë nga adhurimi i diellit, sepse ai ishte edhe mbret, edhe pejgamber.





I shkroi menjëherë një letër Belkisit
dhe e urdhëroi Hud-hudin duke i thënë: “Çoja këtë
letër asqj!”

Hud-hudi e mori letrën, hapi pendët dhe fluturoi
drejt sarajit të Belkisit..

Ç’kishte shkruar Pejgamberi Sulejman në letrën e tij?
Belkisi e mësoi këtë kur mori letrën:

“Ti dhe populli yt duhet të hiqni dorë nga adhurimi i
vazhdueshëm ndaj diellit!

Besoni në Allahun që është zoti i tokës, qiejve dhe pa
dyshim edhe i diellit!”

Kur Belkisi lexoi letrën, thirri komandantët
Disa prej tyre thanë: "T'i shpallim luftë Sulejmanit!
Ta djegim, ta rrënojmë!"
Mirëpo Belkisi ishte mbretëreshë e mençur dhe u
përgjigj duke u thënë: "Lufta na mjeron!"
Dërgoi delegatët e saj drejt Pejgamberit Sulejman
bashkë me dhurata të vyera.





Delegatët, pas një udhëtimi të gjatë,
arritën në sarajin e Pejgamberit Sulejman.
Nxorën nga sëndukët dhurata, gurë të çmuar,
margaritarë, perla dhe i vendosën para tij.
Pejgamberi Sulejman nuk e ktheu kokën të shohë
asnjërën prej tyre.
Delegatët u habitën shumë!
Kush mund të rezistonte të mos shihte këto dhurata
të çmuara?

Pejgamberi Sulejman u tha:

“Nëse nuk hiqni dorë nga adhurimi i diellit dhe nëse nuk besoni në Allah,

zotin e diellit dhe të gjithë yjeve të tjerë,

vij bashkë me ushtrinë time në vendin tuaj!”

Dhe nuk i pranoi dhuratat, por i ktheu pas bashkë me delegatët

Kur delegatët arritën te mbretëresha,

i treguan gjithë ç'kishte ndodhur.





I treguan për pasurinë marramendëse të
Pejgamberit Sulejman...

Dhe për sarajin e tij madhështor...

Dhe për ushtrinë e tij të fuqishme, që përbëhej nga
njerëz e kafshë të llojlojshme...



Belkisi u tha:


“Këto duhet t'i shoh me sytë e mi dhe të flas personalisht me Sulejmanin.

Ndoshta ai nuk është thjesht një mbret!

Duhet të kuptoj se kush është!”

Menjëherë u bënë përgatitjet

Mbretëresha e Sebesë u nis për rrugë me një karvan të madh.





Belkisi kishte një fron shumë të çmuar,
të cilin, para se të nisej për rrugë,
e mbylli në një dhomë me disa kyçe njëherësh.
Tashmë askush nuk mund të hynte atje.
Pejgamberi Sulejman e mësoi që Belkisi ishte nisur
për rrugë dhe tha: "Kush mund të ma sjellë fronin e
saj përpara se mbretëresha të arrijë këtu?"
Njëri me emrin Ifrit, i cili dinte gjërat e fshehta dhe
të jashtëzakonshme, ia ktheu: "E sjell unë!"


Sa hap e mbyll sytë solli në sarajin e Pejgamberit
Sulejman fronin e Belkisit!

Karvani vazhdonte rrugën për te Sulejmani
dhe pas pak kohe Belkisi arriti në sarajin e
mahnitshëm të Pejgamberit Sulejman.

Ngado që të shihte i vezullonin sytë,
mbetej e admiruar.

Kur pa fronin e saj atje u habit edhe më shumë!
Pejgamberi Sulejman e ftoi atë në një saraj prej
xhami.





Çdo anë e sarajit ishte prej xhami, madje edhe
dysHEMEJA!
Për më tepër, nën të rridhte ujë
dhe brenda tij dukeshin peshqit e shumëngjyrshëm
që notonin.
Belkisi nuk kishte parë ndonjëherë diçka të tillë.
Tërhoqi fundin e fustanit lart që të mos lagej.
Ky veprim e bëri Pejgamber Sulejmanin të qeshte.
I tha: “Mos ki frikë! Nuk laget, ky është një saraj prej
xhami.”

Belkisi e kuptoi se Pejgamberi Sulejman nuk ishte
thjesht një mbret,
sepse të gjitha këto gjëra të habitshme
nuk ishin punë që mund t'i bënte një njeri!
Ndoshta ai ishte një pejgamber!
Dhe Belkisi i dha të drejtë Pejgamberit
Sulejman.

Ndjeu pendesë për ditët kur kishte
adhuruar diellin,
shprehu besim ndaj Allahut dhe u bë
robëreshë e tij.

Edhe populli Sebe, ashtu si
mbretëresha e tyre,
hoqën dorë nga adhurimi i
diellit

Besuan në Allahun që kishte
krijuar diellin dhe të gjitha yjet e
tjera.





Mjaft shtete të tjera, nën orientimin e Pejgamberit Sulejman, hoqën dorë nga adhurimi ndaj zjarrit, diellit, malit, gurëve dhe idhujve dhe shprehën besim ndaj Allahut..

Ndaj Allahut që kishte krijuar lulet, yjet, milingonat dhe drenushat sybukura...

